



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA)**

Nr. 966/1 prot.
Tiranë, më 09. 12.2020

**MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE
FALAS**

Nr. 632/1 prot.
Tiranë, më 09. 12.2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

Sot më datë, 09. 12.2020, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), me seli në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, i cili është një person juridik publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Lorin YMERI, këtu e në vijim “ADISA”,

DHE

Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me adresë: Rruga e Barrikadave Nd. 18, Hyrja nr. 6, zyra nr. 10 – III, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Ergys Qirici, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, këtu e në vijim “Drejtoria”,

Palët, bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si “**Marrëveshja**”), si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

- 1.1 Në Marrëveshje midis tyre, palët bien dakord që brenda ambienteve të *Zyrave Rajonale/Vendore të ADISA-s* (në vijim *Qendrat e Integruara*), Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, do t’i vihet në dispozicion poste pune të dedikuara për ofrimin e shërbimeve në bazë të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- 1.2 Numri i posteve të punës, të cilat do të vendosen në dispozicion të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, do të përcaktohen nga ADISA, pasi të jenë dakordësuar nga të dyja palët, si

dhe në varësi të fluksit të kërkesave të qytetarëve për paketën e shërbimeve dhe hapësira fizike të Zyrave Rajonale/Vendore.

Neni 2 **Baza Ligjore**

- 2.1 Për lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshje, palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore si më poshtë:
- Neni 119 dhe 121 i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
 - Nenet 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
 - Ligji Nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”;
 - Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
 -

Neni 3 **Afati i Marrëveshjes**

- 3.1 Afati i kësaj Marrëveshje është 2 (dy) vjet, me të drejtë rinovimi dhe fillon nga data e nënshkrimit të saj nga palët.
- 3.2 Marrëveshja rinovohet automatikisht për një periudhë kohe të pacaktuar, nëse asnjëra nga palët nuk njofton me shkrim palën tjetër për përfundimin e saj, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të afatit të përcaktuar sipas pikës 3.1 të këtij neni.

Neni 4 **Të drejtat dhe detyrimet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas**

- 4.1 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas merr përsipër:
- 4.1.1 Të ofrojë shërbimet e saj në sportelet e Zyrave Rajonale/Vendore të vendosura në dispozicion nga ADISA pa kundërshtim.
 - 4.1.2 Të pajisë sportelet e saj me të gjitha pajisjeve të nevojshme TIK (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj.), duke siguruar kushte normale pune;
 - 4.1.3 Bën të mundur funksionimin e sistemit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (*nëse ekziston një i tillë*), të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve të saj në sportelet e Qendrave të ADISA-s.
 - 4.1.4 Të vendos në dispozicion punonjësit e ngarkuar prej saj për ofrimin e shërbimeve në sportel, të cilët duhet të respektojnë tërësinë e rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel.
 - 4.1.5 Të pranojë ankesat e qytetarëve në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve të mbledhura nga punonjësit e ADISA-s, pranë Qendrave të Integruara të cilat

- i përcillen me shkrim në fund të çdo dite. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas shqyrton ankesat brenda afateve ligjore dhe në varësi të shkeljes merr masat e nevojshme ndaj punonjësve përkatës.
- 4.1.6 Të ushtrojë të gjitha detyrat të ngarkuara sipas përcaktimeve të ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, dhe kuadrin ligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë e saj në hapësirën e caktuar, ashtu si janë ushtruar edhe përpara nënshkrimit të kësaj marrëveshje.
 - 4.1.7 Të mirëmbajë të gjitha mobiliet, pajisjet dhe mjetet e tjera të dhëna në përdorim nga ADISA gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes dhe i dorëzojë ato në gjendje pune në momentin e përfundimit të Marrëveshjes, duke marrë në konsideratë amortizimin normal të tyre.
 - 4.1.8 Të sigurojë bazën materiale të domosdoshme për funksionimin e sporteleve të saj dhe ofrimin e shërbimeve.
- 4.2 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka të drejtë të përdor sportelet e vendosura në dispozicion nga ADISA pranë Zyrave Rajonale/Vendore, për ofrimin e shërbimeve të saj.
 - 4.3 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka të drejtë të përdor Sistemin e Menaxhimit të Radhës (Queue Management), të vendosur në ambientet e Zyrave Rajonale/vendore, për ofrimin e shërbimeve të saj.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e ADISA

5.1 ADISA merr përsipër:

- 5.1.1 Të vendosë në dispozicion pa kundërshtim, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas poste pune, në ambientet e Zyrave Rajonale/Vendore, të mobiluara (*post pune i kompletuar me tavolinë, karrige, raft*), duke siguruar kushte normale pune dhe akses nga publiku;
- 5.1.2 Të trajtojë punonjësit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas që do të shërbejnë në sportel, lidhur me etikën e komunikimit, modelet e sjelljes, menaxhimit të presionit në punë etj., me qëllim përgatitjen e tij për të ofruar shërbimin në mënyrë sa më të shpejtë dhe cilësore për qytetarin;
- 5.1.3 Të sigurojë sistemin e menaxhimit të radhës, edhe për sportelet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, në mënyrë elektronike dhe të përbashkët me sportelet e tjerat të Qendrës së Integruar;
- 5.1.4 Të ofrojë informacion për qytetarët nëpërmjet sportelit të informacionit (info-point) lidhur me shërbimet e ofruara nga sporteli i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas;
- 5.1.5 Të mbledh dhe administrojë ankesat e qytetarëve në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit nga punonjësit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, që shërben në sportel dhe ia përcjell me shkrim këtij të fundit.

- 5.1.6 Të marrë në dorëzim në përfundim të Marrëveshjes ambientet e dhëna në përdorim, mobiliet dhe pajisjet në gjendjen që i ka dorëzuar, duke konsideruar amortizimin normal të tyre.
- 5.2 ADISA ka të drejtë të kërkojë nga punonjësit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, të cilët ofrojnë shërbime publike vendore, zbatimin e standardeve dhe rregullave të ofrimit të shërbimeve publike në sportel.

Neni 6

Veprimtaritë e përbashkëta

- 6.1 Palët nëpërmjet strukturave të përcaktuara për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje, marrin përsipër të kryejnë bashkërisht:
- 6.1.1 hartimin dhe zbatimin e skemave të veprimtarisë së përbashkët;
 - 6.1.2 informimin e publikut, mbi llojin dhe procedurat e shërbimeve të ofruara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore;
 - 6.1.3 shkëmbimit të informacionit, me kërkesë paraprake, brenda fushës së kompetencave dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim kryerjen e analizave dhe studimeve sa i përket skemës së ndihmës juridike falas të garantuar nga shteti;
 - 6.1.4 promovimin e fushave të zbatimit të parashikuar në ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, duke organizuar aktivitete sensibilizuese dhe edukative, për atë që nuk kërkojnë angazhime buxhetore.

Neni 7

Punonjësit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

- 7.1 Punonjësit, të cilët ofrojnë shërbimet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, pranë ambienteve të Zyrave Rajonale/Vendore të ADISA-s, është punonjës i këtij institucioni, i emëruar në bazë të legjislacionit në fuqi dhe përcaktimeve të kontratës individuale të punës.
- 7.2 Marrëdhënia e tij e punës mbetet në fuqi dhe nuk transferohet te ADISA gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje.
- 7.3 ADISA nuk ka detyrime financiare ndaj punonjësit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, i cili shërben në sportelet e vendosura në hapësirat e Zyrave Rajonale/Vendore.
- 7.4 Punonjësit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, kanë detyrimin të marrin pjesë në trajnimet që organizohen nga ADISA në kuadër të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve publike në sportel.
- 7.5 Punonjësit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, respektojnë tërësinë e rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel.

Neni 8

Shpenzimet për funksionimin e sporteve

- 8.1 Shpenzimet për funksionimin e sporteve përballohen nga Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, dhe mbulojnë shpenzimet për pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjësin e sportelit, si dhe shpenzimet operative (bojë për pajisjet, letër, kancelari etj.) për mirëfunksionimin e sportelit të shërbimit.
- 8.2 ADISA merr përsipër të sigurojë vendosjen në dispozicion të postit të punës brenda ambienteve të Zyrave Rajonale/Vendore, si dhe furnizimin e ambienteve të punës me linjë interneti, energji elektrike dhe ujë të pijshëm.
- 8.3 Pajisjet që jepen në përdorim gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes mbeten në pronësi të ADISA, e cila merr përsipër edhe amortizimin normal të tyre.

Neni 9

Komunikimet midis palëve

- 9.1 Të gjitha komunikimet e palëve në lidhje me këtë kontratë do të bëhen me shkrim duke u adresuar me postë normale apo elektronike në adresat e zyrave qendrore të palëve ose adresat e email-it si më poshtë:

Për ADISA-n:

Z. Enea Turlla

Pozicioni: Projektor Sektorit të Mbrojtjes së Lëvizimit të Shërbimeve

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Arh" ish Hoteli oficerave, kati 6 Tiranë

E-mail: enea.turlla@adisa.gov.al

067 2939990

Për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas:

Z./ Znj. Patricia Pogace

Pozicioni: Drejtori i Drejtësisë së Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike

Adresa: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas

E-mail: patricia.pogace@drejtësia.gov.al

0682583445

Neni 10
Orari i funksionimit të sportelit

- 10.1 Orari i pranimit të aplikimeve për sportelin është:
E hënë - E premte ora 08:00 - 15:00
- 10.2 Orari gjatë të cilit ambientet e ADISA-s mund të përdoren nga punonjësi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, sipas kësaj Marrëveshje është 08:00-16:30 çdo ditë pune.
- 10.3 Përgjegjësit e sporteleve të Zyrave Rajonale/Vendore do të raportojnë për paraqitjen e punonjësit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, çdo ditë zyrës së burimeve njerëzore të këtij të fundit.

Neni 11
Shkëmbimi i informacionit dhe i dokumentacionit

- 11.1 Procesi i ofrimit të shërbimit në sportel do të bëhet në bazë të rregullimeve ligjore/nënligjore/kontraktuale në fuqi për ofrimin e shërbimeve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, dhe ligjit nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për ofrimin e shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, për aq sa ky i fundit nuk bie në kundërshtim me rregullimet ligjore aktuale për ofrimin e këtyre shërbimeve.
- 11.2 Me kërkesë të ADISA-s, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, i vë në dispozicion kësaj të fundit raporte në lidhje me aplikimet dhe afatet e përgjigjeve për aq sa është e mundur nga legjislacioni në fuqi.
- 11.3 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, vendos në dispozicion të punonjësit të sportelit të informacionit (info-point) të ADISA pranë Zyrave Rajonale/Vendore, materiale informuese të saj, si broshura dhe informacione të tjera në lidhje me shërbimet përkatëse.

Neni 12
Zgjidhja e Marrëveshjes

- 12.1 Marrëveshja përfundon me përmbushjen e afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj.
- 12.2 Marrëveshja mund të zgjidhet nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në rast se nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme për ofrimin e shërbimit nga ADISA, si:
- Vënia në dispozicion e postit të punës;
 - Vënia në dispozicion e mobilieve;
 - Furnizimi me internet.
- 12.3 Marrëveshja mund të zgjidhet nga ADISA në rast se:
- Punonjësi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, nuk respekton në mënyrë të përsëritur tërësinë e rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel;

- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, nuk siguron bazën materiale dhe pajisjet TIK të nevojshme për funksionimin e sporteve dhe ofrimin e shërbimit.
 - Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, nuk respekton detyrimet e tjera të parashikuara sipas Nenit 4.
 - Për shkaqe të tjera objektive në interes publik.
- 12.4 Marrëveshja mund të zgjidhet përpara përmbushjes së afatit për shkaqe të arsyeshme me kërkesë të njërës palë, duke e njoftuar palën tjetër me shkrim, të paktën 3 (tre) muaj përpara.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 13.1 Çdo mosmarrëveshje që lind ose mund të lindë nga ose gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

Neni 14

Hyrja në fuqi

- 14.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 15

Dispozita të fundit

- 15.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u hartua në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) kopje për secilën palë, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe.


PALËT

PËR

**AGJENCINË E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA)**

DREJTOR EKZEKUTIV

Lorin YMERI



PËR

**DREJTORINË E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys QIRICI

